



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

Nr. 3363/1 Prot.

Tiranë, më 25.08.2009

V E N D I M

Nr. 944, datë 25.08.2009

**Mbi nxjerrjen e vendimit të ndërmjetëm për procedimin administrativ për
"Zgjidhje Mosmarrveshje interkoneksioni midis AMC dhe Eagle Mobile "**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Ilir Shehu	Kryetar
2. Z. Afrim Tonuzi	Anëtar
3. Znj. Edlira Kasaj	Anëtar
4. Z. Ilir Zela	Anëtar
5. Z. Jetmir Karini	Anëtar

ne praninë e sekretarit të Këshillit Drejtues, në mbledhjen e datës 25.08.2009, , në vijim të procedurës së përcaktuar në nenin 7 e vijues të Rregullores së Brendëshme të AKEP, vendimit Nr. 918 datë 30.07.2009 të Këshillit Drejtues "Për fillimin e procedimit administrativ "Zgjidhjen e mosmarrëveshjes Interkoneksionit midis AMC dhe Eagle", mori në shqyrtim relacionin e Nr. 3317 Prot., datë 25.08.2009.

BAZA LIGJORE:

1. Neni 78 e në vijim i Ligjit Nr.8584 datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative" (*Kodi i Procedurave*)
2. Ligji Nr.9918 datë 19.05.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë" (*ligji nr.9918*)
3. Pika 8 e Kreut VI, të rregullores "Për aksesin dhe interkoneksionin" (*Rregullorja*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 416, datë 7.12.2007 dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;
4. pika 17 e nenit 21 të "Rregullores së Brendëshme të AKEP (*Rregullorja e Brendëshme*), e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;
5. Vendimi Këshillit Drejtues Nr. 918 datë 30.07.2009 "Për fillimin e procedimit admisnitrativ "Zgjidhjen e mosmarrpveshjes Interkoneksionit midis AMC dhe EAGLE"

Nga shqyrtimi i materialit të paraqitur, seancës dëgjimore të zhvilluar në datë 11.08.2009, fakteve dhe argumentave të dorëzuar nga palët, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

V Ë R E H E T se :

1. Në zbatim të nenit 50 të Ligjit 9918 dhe nenit 66 të Kodit të Procedurave Administrative, me vendimin e Këshillit Drejtues Nr. 918 datë 30.07.2009, filloi procedimi administrativ për shqyrtimin e pretendimeve të palëve për moslidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit.

Në zbatim të pikës 2 të VKD NR.918 palët në procedim (Eagle Mobile dhe AMC) paraqitën pretendimet e provat me shkresat e mëposhtëme:

- Shkresa Nr. 922 datë 04.03.2009 e EM drejtuar AMC
- Shkresa Nr.1032 datë 11.03.2009 e EM drejtuar AMC.
- Shkresa Nr.1214 datë 25.03.2009 e EM drejtuar AMC për dijeneri AKEP.
- Shkresa Nr.1934 datë 13.05.2009 e EM drejtuar AMC për dijeneri AKEP.
- Shkresa Nr.2200 datë 28.05.2009 e EM drejtuar AKEP.
- Shkresa Nr.1544/1 datë 19.03.2009 e AMC drejtuar EM.
- Shkresa Nr.2068 datë 07.04.2009 e AMC drejtuar EM për dijeneri AKEP.
- Shkresa Nr.1544/4 datë 22.05.2009 e AMC drejtuar EM për dijeneri AKEP.
- Shkresa Nr.649 datë 07.08.2009 e EM drejtuar AKEP.
- Shkresa 4304/2 datë 07.08.2009 e AMC dërguar AKEP për dijeneri AMC

2. Pika për të cilat Eagle Mobile dhe AMC nuk kanë arritur marrëveshje.

Tarifa e terminimit te Eagle Mobile për periudhën Shtator 2009- Mars 2010.

3. Në zbatim të nenit 3 të VDK Nr.918 u zhvillua seanca dëgjimore në AKEP në datën 11.08.2009.

ATËHERË:

Këshilli Drejtues, në zbatim të nenit 78 të Kodit të Procedurave konstaton se:

Situata aktuale e tregjeve është në rishqyrtim. Dokumenti i analizës së tregut për telefoninë e levizëshmer është në fazën e këshillimit publik dhe vetëm pas marrjes dhe vlerësimit të mendimeve të palëve të interesuara, AKEP do të marrë një vendim përfundimtar, me përfundimin e periudhës së këshillimit publik më datë 15.09.2009. Vetë operatorët, të cilët janë ftuar të japin pikëpamjet e tyre rreth dokumentit të analizës së tregjeve të telefonisë së lëvizshme, Eagle Mobile, Vodafone Albania dhe Albtelecom, në marrëveshjet e interkoneksionit të lidhura janë shprehur se, në momentin e ndryshimit të tarifës së operatorit OFNT (bazuar në RIO), do të negociojnë rishikimin në ulje të tarifës lidhur me

terminimin e trafikut në rrjetin e operatorit Eagle Mobile. Periudha nga hyrja në fuqi e tarifave të periudhës së dytë të rregullimit për operatorët OFNT më 01 Shtator 2009 deri në përfundimin e analizës së re të tregjeve dhe përcaktimin e detyrimeve rregullatore propocionale është mjaft e shkurtër. Njëkohësisht AKEP mban parasysh afatet kohore shumë të shtrënguara për sa i takon shqyrtimit dhe marrjes së një vendimi përfundimtar për procedimin administrativ të nisur në mënyrë që të sigurohet zbatimi i tij brenda afateve ligjore të kërkuara si edhe kryerja e pasqyrimeve të duhura edhe në raporte të tjera mes aktorëve të tregut. Nga ana tjetër, mosmarrja e këtij vendimi të ndërmjetëm do të sillte si pasojë shkaktimin e një dëmi të pariparueshëm mbi interesat publikë. AKEP ndërkohe do te vazhdojë procedimin administrativ te nisur me VKD Nr. 918, datë 30.07.2009, dhe do te dalë me vendim përfundimtar brenda afateve ligjore.

Për sa më sipër Këshilli Drejtues;

V E N D O S I :

1. Eagle Mobile Sh.a. duke filluar nga data 1 Shtator 2009 deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar për Analizën e Tregut të Telefonisë së Lëvizëshme nga AKEP të aplikojë një tarifë maksimale terminimi në rrjetin e tij prej 13.32 lekë/min.
2. Varesisht gjetjeve te analizës, tarifa e terminimit për periudhën pas përfundimit të procesit te analizës së tregjeve të telefonisë së lëvizëshme për Eagle Mobile Sh.a. do të përcaktohet në përputhje me përfundimet të Analizës se Tregjeve të Telefonisë së Lëvizëshme.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

KRYETAR I KËSHILLIT DREJTUES

Ilir SHEHU

Anëtarë të Këshillit Drejtues:

1. Afrim TONUZI
2. Edlira KASAJ
3. Ilir ZELA
4. Jetmir KARINI